

Vendim nr. 235 datë 24.09.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 24.09.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 17 (E) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ENI (ENGLEND) ÇOLLAKU, përfaqësuar nga avokatët Saimir Vishaj dhe Alfred Bari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 958, datë 10.06.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 165, datë 12.04.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-2160 (302), datë 10.12.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 50, pika 4, 51/a, pika 1, shkronja “b”, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me shkresën nr. 2633/1 prot., Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë me nr. 3441/1, datë 01.10.2018, që i ka dhënë rrugë kërkesës së autoriteteve greke të drejtësisë, konkretisht Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Kretës Lindore, sipas legjislacionit grek, për fillimin e ndjekjes penale ndaj një shtetasi shqiptar ende të paidentifikuar, të njohur si Eni Çollaku, banues në Tiranë, i akuzuar nga autoritetet greke, në mungesë, për veprat penale “Përdhunimi në mënyrë të përsëritur” dhe “Mashttrimi të të miturës në mënyrë të përsëritur”.

2. Në datën 23.11.2018, mbi bazën e materialeve hetimore të dërguara (nën formën e transferimit të procedimit) nga shteti grek, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 9162 për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”, më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 101, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP).

3. Me transferimin e materialit procedues penal në Shqipëri nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është bërë e mundur të identifikohet dhe të gjendet shtetasi shqiptar Engelent Boriçi ailas Eni Çollaku (*kërkuesi*).

4. Në përfundim të hetimeve paraprake, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 101, paragrafi 2, i KP-së, në dëm të viktimës së mitur D.R.

5. Në seancën gjyqësore të datës 25.10.2019 gjykata ka vendosur papranueshmërinë e kërkesës për deklarimin e pavlefshmërisë absolute të procesverbalit të datës 28.05.2019, për pyetjen e të pandehurit, pasi sipas deklaratave të prokurorit në këtë seancë, ky procesverbal nuk do të jetë pjesë e fashikullit hetimor, si dhe rrëzimin e kërkesave të mbrojtjes për pavlefshmërinë absolute të: “Vendimit për marrjen personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” të datës 13.05.2019; “Njoftimit mbi përfundimin e hetimeve të datës 28.05.2019”, sepse, referuar akteve të seancës gjyqësore për kalimin e çështjes në gjyq, të pandehurit i janë garantuar të drejtat, duke i siguruar një mbrojtës. Sipas gjykatës, nga mbrojtësi dhe vetë kërkuesi gjatë gjykimit në seancën paraprake për kalimin e çështjes në gjyq nuk janë kundërshtuar aktet e mësipërme dhe janë pranuar pasojat e tyre.

6. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 958, datë 10.06.2020, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”, më shumë se një herë, bazuar në nenin 101/2 të KP-së dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim, pasi bazuar në provat e marra dhe të verifikuara në hetimin gjyqësor, gjykata ka krijuar bindjen se

i pandehuri (kërkuesi) me veprimet e kundërligjshme të kryera ka konsumuar plotësisht elementet e figurës së veprës penale, për të cilën akuzohet. Në vlerësimin e asaj gjykate, pretendimet e mbrojtjes për deklarimin e kërkuesit të pafajshëm ose për ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale janë të pabazuara në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 165, datë 12.04.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai është rrjedhojë i një procesi gjyqësor të zhvilluar në respektim të dispozitave procedurale penale dhe se ajo gjykatë ka bërë një analizë ligjore të saktë të fakteve të provuara në atë gjykim, duke arritur në përfundime të bazuara. Në përfundim, kjo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe në ankimin e të pandehurit nuk gjen shkaqe për ndryshimin e tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi nëpërmjet mbrojtësve të tij.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin 00-2024-2160 (302), datë 10.12.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, pasi është marrë në interpretim të drejtë të ligjit procedural dhe material penal, bazuar në nenin 441, pika 1, shkronja “e”, të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Sipas Kolegjit Penal, cilësimi juridik i faktit penal në veprën penale, për të cilën është dënuar kërkuesi që ka rezultuar i provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor me procedurë të zakonshme, është i saktë dhe i argumentuar në përputhje me nenet 151 dhe 383 të KPP-së. Ndërsa pretendimet e parashtruara në rekurs dhe në seancë gjyqësore, për sa lidhen me vlerësimin e provave, dalin jashtë juridiksionit ligjor të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 10.06.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.06.2025.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

10.1. *Së drejtës së aksesit dhe asaj për t’u mbrojtur*, pasi duke pasur parasysh akuzën që i atribuohet kërkuesit, mbrojtja e tij me një avokat në seancën paraprake ishte e detyrueshme. Gjykata e apelit ka bërë një interpretim të

gabuar për përfaqësuesin ligjor të kërkuarit gjatë seancës paraprake. Duke iu referuar vendimit nr. 2914, datë 21.06.2019, konstatohet se në seancën e parë dhe të fundit gjyqësore të seancës paraprake kërkuari është përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht, i cili, pa u njohur me aktet dhe çështjen, ka marrë përsipër vazhdimin e gjykimit të tij. Edhe Gjykata e Lartë nuk evidenton faktin që gjatë seancës paraprake kërkuari është përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata në datën 21.06.2019 dhe po atë ditë, pa i dhënë mundësi përfaqësuesit ligjor të njihet me aktet, si dhe të takojë personalisht kërkuarin, është zhvilluar procesi gjyqësor, si dhe është dhënë vendimi nga ajo gjykatë.

- 10.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë bërë një analizë formale dhe të pathelluar të të gjitha problematikave të ngritura nga kërkuari. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i cunguar dhe i pambështetur në ligj, pasi nuk ka arsyetuar kërkesat konkrete të kërkuarit. Absurditeti i vendimit të gjykatës së shkallës së parë qëndron në faktin se nga ana e organit të akuzës është kërkuar që procesverbali i datës 28.05.2019 “Për pyetjen e të pandehurit” të mos jetë pjesë e fashikullit hetimor, kërkesë e cila rezulton të jetë pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Në rastin konkret, gjykata duhet të jepte vendimin duke u bazuar në fakte dhe prova, të cilat ajo i çmonte të vlefshme e të përdorshme, referuar nenit 352 të KPP-së, dhe jo të hiqte akte nga dosja. Edhe gjykata e apelit, për kërkesën e mbrojtjes për pavlefshmërinë absolute të procesverbalit të datës 28.05.2019, nuk arsyeton se përse ky akt është hequr nga dosja, si dhe a ka qenë momenti i duhur procedural për heqjen e tij, dhe cila ka qenë baza ligjore që i referohet për të miratuar ligjshmërinë e veprimeve të gjykatës së shkallës së parë. Për të rrëzuar të gjitha pretendimet e kërkuarit gjykata e apelit është mjaftuar vetëm me një fjali. Edhe Gjykata e Lartë me vendimin e saj ka ligjësuar paligjshmërinë e veprimeve të gjykatave të tjera, duke i konsideruar të drejta dhe të bazuara në ligj. Gjithashtu, ajo gjykatë ka zhvilluar një proces formal, duke mos pasur si qëllim zgjidhjen ligjore të çështjes. Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me nenin 437 të KPP-së, duke i dëgjuar formalisht palët dhe pa bërë pyetje për procesin dhe më pas e ka shtyrë shpalljen e vendimit për shkak të kompleksitetit të çështjes. Ajo gjykatë nuk ka arsyetuar

se për cilat shkaqe ka bërë kalimin e çështjes për shqyrtim nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në verifikim të plotësisht të këtyre kriterëve, në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe si bartës i të drejtave të pretenduara të cenuara ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta.

14. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit gjyqësor i dhënë në çështjen e tij është ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që mban datën 10.12.2024, i cili i është komunikuar kërkuarit nëpërmjet e-mailit në datën 26.02.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 10.06.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit dhe asaj për t’u mbrojtur, pasi në seancën e parë dhe të fundit gjyqësore të seancës paraprake ai është përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht, i cili pa u njohur

me aktet dhe çështjen ka marrë përsipër vazhdimin e gjykimit të kërkuarit. Po kështu, sipas kërkuarit, edhe Gjykata e Lartë nuk evidenton faktin që gjatë seancës paraprake kërkuari është përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata në datën 21.06.2019 dhe po atë ditë, pa i dhënë mundësi përfaqësuesit ligjor të njihet me aktet, si dhe të takojë personalisht kërkuarin, është zhvilluar procesi gjyqësor dhe është dhënë vendimi nga ajo gjykatë.

16. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur akses në gjykatë i garanton individit të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj, për pretendimet e ngritura (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr.17, datë 24.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pranuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal ka përmbajtje substanciale, ajo duhet të jetë reale dhe efektive e jo vetëm teorike, dhe se ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por, përkundrazi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimin nr. 35, datë 01.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, për sa u takon pretendimeve të kërkuarit se në seancën e parë dhe të fundit gjyqësore të seancës paraprake ai është përfaqësuar nga një avokat i caktuar kryesisht, i cili pa u njohur me aktet dhe çështjen ka marrë përsipër vazhdimin e gjykimit të kërkuarit, Kolegji vëren se, referuar akteve të seancës gjyqësore për kalimin e çështjes në gjyq, kërkuari është asistuar nga një mbrojtës, duke iu garantuar të drejtat e tij. Ai ka dhënë shpjegime në këtë seancë në prezencë të avokatit dhe si kërkuari, ashtu edhe mbrojtësi i tij kanë pranuar pasojat e akteve. Për sa më sipër, kërkuari ka pasur mundësi që të caktojë një mbrojtës të zgjedhur personalisht prej tij. Nga ana tjetër, ai nuk ka provuar se mbrojtësi i caktuar kryesisht ka vepruar në kundërshtim me interesat e kërkuarit, duke mos i siguruar mbrojtje efektive ose të mos ketë përmbushur kërkesa thelbësore procedurale. Në këtë kuptim, pavarësisht pretendimeve të kërkuarit, ai nuk ka arritur të provojë rëndësinë e provave me dëshmitarë (A.L.) në raport me provat e tjera shkencore të administruara nga gjykatat dhe të vlerësuara prej tyre në përcaktimin e fajësisë së tij. Gjatë procesit gjyqësor, gjykatat e zakonshme i kanë garantuar kërkuarit të drejtën e mbrojtjes efektive, duke marrë në shqyrtim pretendimet e mbrojtjes së tij, si dhe duke u dhënë atyre përgjigje se përse ishin të pabazuara. Për këtë arsye, ky pretendim i kërkuarit nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke qenë se ky pretendim është me natyrë kushtetuese, *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë bërë një analizë formale dhe të pathelluar të të gjitha problematikave të ngritura nga kërkuesi. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i cunguar dhe i pambështetur në ligj, pasi nuk ka arsyetuar kërkesat konkrete të kërkuesit. Absurditeti i vendimit të gjykatës së shkallës së parë qëndron në faktin se nga ana e organit të akuzës është kërkuar që procesverbali i datës 28.05.2019 “Për pyetjen e të pandehurit” të mos jetë pjesë e fashikullit hetimor, kërkesë e cila rezulton të jetë pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Në rastin konkret, gjykata duhet të jepte vendimin duke u bazuar në fakte dhe prova, të cilat ajo i çmonte të vlefshme e të përdorshme, referuar nenit 352 të KPP-së, dhe jo të hiqte akte nga dosja. Edhe gjykata e apelit për kërkesën e mbrojtjes për pavlefshmërinë absolute të procesverbalit të datës 28.05.2019 nuk arsyeton se përse ky akt është hequr nga dosja, si dhe a ka qenë momenti i duhur procedural për heqjen e tij, dhe cila ka qenë baza ligjore që i referohet për të miratuar ligjshmërinë e veprimeve të gjykatës së shkallës së parë. Për të rrëzuar të gjitha pretendimet e kërkuesit gjykata e apelit është mjaftuar vetëm me një fjali. Edhe Gjykata e Lartë me vendimin e saj ka ligjëruar paligjshmërinë e veprimeve të gjykatave të tjera, duke i konsideruar të drejta dhe të bazuara në ligj. Gjithashtu, ajo gjykatë ka zhvilluar një proces formal duke mos pasur si qëllim zgjidhjen ligjore të çështjes. Një fakt i tillë vërtetohet nga analiza e vendimit të kësaj gjykate, si dhe nga procesverbali i seancës gjyqësore ku konstatohet se kjo gjykatë ka vepruar në kundërshtim me nenin 437 të KPP-së, duke bërë dëgjësë formale të palëve në proces dhe pa bërë pyetje për procesin. Ajo nuk ka arsyetuar se për cilat shkaqe ka bërë kalimin e çështjes për shqyrtim nga dhoma e këshillimit në seancë gjyqësore.

20. Në lidhje me standardin e arsyetimit të vendimit, Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve të Gjykatës së Lartë, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se arsyetimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe se një arsyetim i tillë është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga

argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitat përkatëse procedurale që janë kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nga ana tjetër, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventalisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kërkuesi është proceduar penalisht për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”, më shumë se një herë, bazuar në nenin 101/2 të KP-së dhe është dënuar me 15 vjet burgim. Kërkuesi është mbrojtur nga avokat i zgjedhur gjatë gjithë procesit penal. Në gjykim janë marrë provat e kërkuara nga organi i akuzës, të tilla si, akti i ekspertimit biologjik krahasues i ADN-së së tij, si dhe kampioni biologjik i pështymës, i cili ka rezultuar identik me profilin gjenetik të përfituar nga mbetjet qelizore humane të dërguara nga autoritetet greke.

23. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur të deklarojë fajtor kërkuesin për veprën penale të parashikuar nga neni 101, paragrafi i dytë, i KP-së, duke arsyetuar se, bazuar në provat e marra dhe të verifikuara në hetimin gjyqësor, ajo ka krijuar bindjen se kërkuesi/i pandehuri me veprime të kundraligjshme të kryera ka konsumuar plotësisht elementet e figurës së veprës penale për të cilën është akuzuar. Ajo gjykatë ka arritur në këto konkluzione, sepse procesverbalet e deklarimeve të viktimës dhe të familjarëve të saj të mbajtura përpara autoriteteve greke të drejtësisë përputhen plotësisht me provat shkencore, siç janë: raporti mjeko-ligjor i ekzaminimit gjinekologjik të viktimës; akti i ekspertimit biologjik krahasues i ADN-së, sipas të cilit ka rezultuar se ADN-ja e të pandehurit përputhet plotësisht me profilet gjenetike të dërguara nga autoritetet greke të drejtësisë, të gjetura në vendin e ngjarjes; procesverbalet e ekspertizës në Qendrën Mjeko-Pedagogjike të Ierakleios. Po kështu, në këtë

gjykim, gjykata ka rrëzuar kërkesën e mbrojtjes së paraqitur në fund të hetimit gjyqësor për pyetjen e dëshmitarit A.L., pasi rezulton se ky shtetas nuk është kërkuar të pyetet në hetimet paraprake, nuk i dihet adresa dhe se kjo kërkesë për pyetjen e tij nuk është bërë në momentin e paraqitjes së kërkesës për prova nga ana e mbrojtjes, sipas parashikimeve të nenit 356 të Kodit të Procedurës Penale dhe se nga mbrojtja nuk është paraqitur asnjë shkak që të justifikonte pamundësinë për të paraqitur këtë kërkesë në fazën e kërkesave për prova.

24. Gjukata e apelit, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkuesit, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ekzistenca e faktit penal rezulton plotësisht e vërtetuar nga provat e administruara në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë. Në kundërshtim me pretendimet e të pandehurit se akuza mbështetet vetëm në deklaratimet e viktimës dhe të prindërve të saj, rezulton se fakti penal provohet me prova të tjera shkencore. Ajo gjykatë e ka gjetur të drejtë rrëzimin që gjykata e shkallës së parë i ka bërë kërkesës së mbrojtjes të të pandehurit/kërkuesit për pyetjen e shtetasit A.L., pasi nuk e ka kërkuar gjatë hetimeve nga organi i akuzës dhe as në momentin e paraqitjes së provave në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, për më tepër pa asnjë shpjegim për pamundësinë e bërjes së këtij kërkimi në fazën procedurale të kërkimit të provave e ka kërkuar gjatë gjykimin të gjykatës së shkallës së parë. Ashtu si gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit për deklaratimet që pandehuri/kërkuesi ka bërë përpara organit procedues u janë referuar vetëm deklaratimeve të tij të datës 20.02.2019, ku ka deklaruar se “për periudhën që bëhet fjalë nuk ka qenë fare në Greqi (...) është kthyer nga shteti grek në fund të muajit maj 2016”, pasi në fakt këto janë të vetmet deklaratime të tij që gjenden në fashikullin e hetimit. Në këto kushte, kërkesa e mbrojtjes për “pavlefshmërinë e pyetjes të të pandehurit në datën 28.05.2019” është vlerësuar nga gjykata si një kërkesë pa objekt dhe me të drejtë është rrëzuar nga gjykata e shkallës së parë. Nga ana tjetër, rezulton se në seancën paraprake “Për kalimin e çështjes për gjykim” i pandehuri/kërkuesi ka qenë i asistuar nga avokati mbrojtës i tij dhe nuk janë kundërshtuar aktet e tjera. Sipas gjykatës së apelit, vepra penale është kryer me veprime aktive me dashje të të pandehurit/kërkuesit, i cili, duke qenë i përgjegjshëm përpara ligjit, ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë, në dy raste me viktimën D.R., e cila ka qenë në moshën 16 vjeçare dhe së cilës, nga kryerja e kësaj vepre, i janë shkaktuar probleme depresive. Të drejtë kjo gjykatë ka vlerësuar edhe masën e dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, duke arsyetuar se referuar marrëdhënieve juridike që kjo vepër penale cenon, si dhe fakti që i pandehuri/kërkuesi rezulton të jetë person me precedentë penalë të mëparshëm, rrit bindjen për rrezikshmërinë shoqërore të tij. Po kështu, vepra penale ka shkaktuar tronditje te viktima, e cila ka tentuar vetëvrasjen dhe sipas ekspertimeve mjeko-ligjore ka shfaqur shenja depresioni.

25. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se referuar vendimeve të gjykatave të faktit, akteve të dosjes, si dhe në verifikim të shkaqeve të ngritura në rekurs dhe në seancë gjyqësore, ka vlerësuar se pretendimet e ngritura nga rekursuesi janë të pabazuara, nuk evidentojnë shkaqe të parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe, si të tilla, nuk e cenojnë vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas Kolegjit Penal, vendimi i gjykatës së apelit është marrë në zbatim dhe në interpretim të drejtë të ligjit material e procedural penal, si dhe nenit 441, pika 1, shkronja “e”, të KPP-së. Cilësimi juridik i faktit penal në veprën penale për të cilën është dënuar i gjykuari, që ka rezultuar i provuar gjatë shqyrtimit gjyqësor me procedurë të zakonshme, është i saktë dhe i argumentuar në përputhje me nenet 151 dhe 383 të KPP-së, ndërsa pretendimet e parashtruara në rekurs dhe në seancë gjyqësore për sa lidhen me vlerësimin e provave, dalin jashtë juridiksionit ligjor të Gjykatës së Lartë. Më tej, Kolegji Penal, për sa u takon pretendimeve të parashtruara në rekurs dhe në seancë gjyqësore për pavlefshmërinë absolute të deklarimeve të të pandehurit të datës 28.05.2019, i ka vlerësuar si të pabazuara, për sa kohë gjykatat e faktit nuk i janë referuar për asnjë moment këtij deklarami, por vetëm deklarimeve të të gjykuarit Englent Çollakut, të dhëna në datën 20.02.2019 përpara organit procedues. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, edhe pretendimi se aktet e hetimeve paraprake (vendimi për marrjen të pandehur dhe njoftimin e akuzës dhe njoftimi për përfundimin e hetimeve paraprake) janë akte të absolutisht të pavlefshme për shkak të mungesës së mbrojtësit, prania e të cilit (sipas mbrojtjes) ka qenë e detyrueshme sipas përcaktimit të shkronjës “ç” të nenit 49/1 të KPP-së, Kolegji Penal e ka vlerësuar të pabazuar në ligj (*shih paragrafët 22-44 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

26. Në kuptim të standardeve të mësipërme dhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të dhëna në çështjen e kërkuarit, Kolegji vlerëson se ato tregojnë mjaftueshëm rrethanat e çështjes, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra prej tyre, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ato janë bazuar në zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë. Gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se kërkuari ishte autor i veprës penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuarit, bazuar në një mori provash, përmbajtja e të cilave është analizuar dhe është arsyetuar mjaftueshëm. Gjykatat kanë vlerësuar provat dhe pretendimet e palëve, përfshirë edhe ato të kërkuarit dhe në analizë të tyre kanë zbatuar në vijim ligjin penal ndaj tij. Provat mbi të cilat gjykatat kanë mbështetur vendimet e tyre janë pikërisht ato që i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor dhe në formën e kërkuar nga ligji. Nisur nga kjo, vlerësohet se gjykatat e

faktit që kanë deklaruar fajtor dhe dënua kërkuar kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre, ndërkohë që interpretimi i ligjit prej tyre, i shprehur përmes arsyetimit të vendimit, nuk duket të jetë i paarsyeshëm ose eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Edhe për sa i përket vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ai tregon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe në pjesën arsyetuese argumentet ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Përmes parashtrimit të shkaqeve të rekursit në vendimin gjyqësor të kundërshtuar, sikundër edhe arsyetimit të kufizuar për to, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë tregon se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuar është haptazi i pabazuar, pasi shkaqet e ngritura në të nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

27. Edhe pretendimi i kërkuar se Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar se përse ka kaluar çështja për shqyrtim në seancë gjyqësore është haptazi e pabazuar, pasi jo vetëm që kjo është një çështje që i përket vlerësimit të Kolegjit Penal në dhomën e këshillimit, por për më tepër kërkuar nuk e ka argumentuar në nivel kushtetues cenimin e ndonjë të drejte kushtetuese për këtë shkak.

28. Nga ana tjetër, për sa u përket pretendimeve të kërkuar për mënyrën sesi gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet e çështjes dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe të interpretimit e zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme dhe, si të tilla, nuk përfshihen në juridiksionin e kësaj Gjykate.

29. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më 24.09.2025